



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 3386 prot.

Tiranë, 18.05.2022

URDHËR

Nr. 104 datë 18.05.2022

PËR

**“PËRCAKTIMIN RREGULLAVE PËR PJESËMARRJEN E DREJTORISË SË
INSPEKTIMIT DHE KONTROLLIT NË PROCEDURAT E ASGJËSIMIT TË
PRODUKTEVE/MALLRAVE TË SKADUARA QË INICIOHEN ME KËRKESË TË
VETË SUBJEKTIT”**

Në zbatim të ligjit Nr.10 463 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar, ligjit Nr.10 431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Ligjit nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr.568 datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”,

URDHËROJ:

1. Kërkesat me objekt pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në procedurat e asgjësimit të produkteve, mallrave të skaduara të cilat konsiderohen mbetje (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve) nga kërkuuesi, depozitohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
2. Kur kërkesa për pjesëmarrje të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit depozitohet pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit, Agjencia Rajonale menjëherë e dërgon kërkesën dhe dokumentacionin plotësues në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për t'u proceduar nga Drejtoria e Inspektim Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
3. Kërkesa e subjekteve sipas pikës 1 të këtij urdhëri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - a) Subjektin që do të kryejë transportin, ruajtjen/magazininim e përkohshëm, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve, në zbatim të pikës 5 të nenit 21 dhe nenit, 57, 58 të ligjit nr.10 463 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.
 - b) Klasifikimin e mallrave të skaduara dhe mallrave/produkteve të tjera që konsiderohen mbetje sipas VKM-së nr.402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, duke përcaktuar kodet përkatëse të mbetjeve që do të asgjësohen.
 - c) Regjistrat e transferimit apo dorëzimit të mbetjeve në zbatim të nenit 21 dhe 26 të ligjit nr.10 463 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, VKM-së nr.229 datë 23.04.201 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, VKM-së nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe dokumentit të dorëzimit të tyre.
 - d) Informacionin se si mbetjet do të asgjësohen, në zbatim të shtojcës 1 dhe 2 të ligjit nr.10 463 datë 22.09.2021 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

- e) Të dhëna të plota të kontaktit elektronik të subjektit.
4. Drejtoria e Inspektimit Kontrollit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit pas marrjes në dorëzim të kërkesës për pjesëmarrje në procedurën e asgjësimit verifikon saktësinë, përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij urdhëri.
 5. Kërkesat të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, trajtohen menjëherë duke ju kërkuar subjekteve të bëjnë plotësimin me dokumentacionin e munguar. Komunikimi për plotësimin e dokumentacionit kryhet në rrugë elektronike nga adresa info@akm.gov.al në adresën elektronike të subjektit të deklaruar sipas shkronjës "e" të pikës 3 të këtij urdhëri.
 6. Drejtoria e Inspektimit Kontrollit, ngre grup pune i cili është përgjegjës për pjesëmarrjen dhe ndjekjen e procedurës së asgjësimit sipas rregullimeve ligjore në fuqi dhe përcaktimeve të këtij urdhëri.
 7. Grupi i Punës sipas pikës 6 të këtij urdhëri, krijon çështjen në sistemin online e-inspektimi, dhe dokumenton në sistem të gjitha fazat e procedurës.
 8. Dokumentimi në sistem sipas pikës 7 të këtij urdhëri, përfshin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kontratën e kërkuarit me operatorin që do të kryej transportin e mallrave/produkteve të skaduar/dëmtuara të destinuara për asgjësim.
 - b) Kontratën e stacionit të transferimit të mbetjeve me pikën fundore (landfill) në rastet kur aplikohet;
 - c) Dokumentin e transferimit sipas VKM-së, ku përcaktohet, krijuesi, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi i mbetjeve;
 - d) Licensë III.2B të operatorit që kryen procesin e transferimit nga krijuesi tek pritësi i mbetjeve;
 - e) Leja Mjedisore e pritësit të mbetjeve;
 - f) Fletën e peshimit të pritësit të instalimit përkatës, të mbetjeve të transferuara;
 - g) Foto dhe video nga procesi;
 - h) Raportimet e pritësit e mbetjeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pas trajtimit të mbetjeve të pranuar sipas dokumentit të transferimit.
 9. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Inspektimit Kontrollit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtoritë Rajonale të Mjedisit.
 10. Me miratimin e këtij urdhëri, shfuqizohet urdhëri nr. 22, datë 02.02.2022.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

